

BASHKIA E TIRANËS

1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
Emri Bashkia e Tiranës
Adresa Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001
Tel/Fax 00 355 4 22 56 799
E-mail infrastruktura.prokurime@tirana.al
Faqja e Internetit www.tirana.al

2. Lloji i procedurës “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me rrugëshkresore”, Përdorimi i procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës përcaktohet në Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 34 “Aktekspertiza e thelluar e ndërtesave të dëmtuara” dhe Neni 44 “Procedura e prokurimit në kushtet e Emergjencës” ku cihet se: “Për nevoja emergjente në verifikimin e dëmeve, lidhjen e kontratave të konsulencës, blerjen e pajisjeve të rëndësishme parësore për gjendjen e krijuar dhe përjashtimisht në rastet e pamundësisë së përdorimit të procedurave të parashikuara në këtë ligj, me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, autoritetet përgjegjëse shtetërore përdorin procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Procedura e prokurimit publik në këtë rast zhvillohet në formë shkresore”. Gjithashtu në mbështetje të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 33 pika 2/c si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) kreu IV, neni 36, pika 2, gërma (c).

3. Objekti i kontratës: Loti i Parë: “Aktekspertizë e thelluar për objektet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, të klasifikuara sipas shkallës së dëmtimit DS 4 dhe DS 5, në Njësinë Administrative Nr.5 dhe Njësinë Administrative Nr.9”

3.1 Numri i referencës së procedurës/lotit: Nuk ka

4. Fondi limit: 13,295,858.33 (trembëdhjetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH

